

Iva ZEMANI u lind më 8 qershor 1991, në Tiranë. Është e martuar dhe ka dy fëmijë. Në vitin 2012 ka përfunduar studimet e larta në nivel Bachelor pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, diplomuar me medalje ekselence. Në vitin 2014 ka përfunduar studimet master në programin e studimit “Master Shkencor- E Drejtë Civile”.

Përgjatë periudhës 2014-2016 është angazhuar si pedagoge pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Politike, Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës, në lëndë të së drejtës publike dhe civile.

Gjatë viteve 2016-2019 ka ndjekur studimet pranë Shkollës së Magjistraturës dhe në përfundim ka marrë titullin “Magjistrat në profilin Gjyqtar”. Në vitin 2020 është emëruar gjyqtare me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe është caktuar në pozicionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Me vendimin nr. 434, datë 14.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtare Iva Zemani është komanduar në pozicionin e ndihmësmagjistratit pranë Gjykatës së Lartë.